

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 29.07.2022

Numri i vrojtimit të lejes:

07 Nr.562/350-36976

- Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së z. Ilir Mazreku nga Suhareka, Komuna Suharekë, me 07 Nr. 350-36976 dt. 22.06.2022 - në të cilën kërkon dhënien e lejes për shfrytëzimin e tokës shoqërore para lokalit të tij afarist, në bazë të nenit 8 alinea 8.9 pika 8.9.1 të Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015, nenit 5 pika 5.2 al. 5.2.2, nenit 8 pika 8.3, nenit 9 al. 9.19.7, nenit 5, 8, 9, 11, 12, 13 dhe 14 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private 01-Nr.16-4719 të datës 30.06.2016 si dhe Procesverbalit 07Nr.510/350-36976 të dt. 18.07.2022, bie këtë:

PËLQIM

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Ilir Mazreku	Nr. Personal	
Adresa:	NT. "Kujtimi" Rr. "Brigada-123"- Suharekë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim-për shfrytëzim të hapsirës publike për ekspozim të mallrave.

Përshkrimi:

I LEJOHET - investuesit - z. **Ilir Mazreku** nga Suhareka, Komuna Suharekë, vendosja - ekspozimi i biçikletave , materialit të ndryshëm tekstil dhe prodhimeve plastike që nuk prishen nga ndikimet e jashtme dhe pësojnë konsumatorët etj. , si dhe shfrytëzimin e pasurisë - hapësirës publike para lokalit të tij afarist NT. "**Kujtimi**", në parcelën kadastrale Nr.1100-0, e cila evidentohet sipas fl. poseduese Nr. P-72116046-01100-0, kom. kad. Suharekë, pronë shoqërore - vendi i quajtur fshat, në rrugën "Brigada-123" në Suharekë.

Vendosja - ekspozimi i mallrave të cekur më lartë, si dhe shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës shoqërore - hapsirës publike - **lejohet me karakter të përkohshëm sezonal** dhe vlen nga data **18.07.2022** deri më **31.10.2022**, me mundësi të vazhdimit pas shqyrtimit të rrethanave të reja të krijuara dhe dispozitave tjera ligjore.

Shfrytëzuesi do të shfrytëzojë platonë në një sipërfaqe prej **12.00 m²**, për të cilën do të paguaj sipas Rregullores së Komunës së Suharekës për shfrytëzimin e pasurisë - tokës shoqërore, dhe atë **3 euro për m² në muaj**, shuma për pagesë prej **18.07.2022** deri me **31.10.2022** është gjithsejtë: **124,24 Euro**.

Investuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër.

Gjithashtu hapësira e cila i jepet në shfrytëzim nuk lejohet të kufizohet (rrethohet) .

Trotuari duhet të jetë i lirë dmth. shfrytëzimi i sipërfaqes së lejuar duhet të shfrytëzohet në atë mënyrë që të mos e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve (këmbësorëve) në trotuar.

Për nevoja më të mëdha të realizimit të planit urbanistik të asaj pjese të Suharekës, ku lejohet shfrytëzimi i kësaj hapësire për vendosjen e përkohshme të objekteve të cituara më lartë, investuesit edhe para skadimit të afatit të caktuar me këtë Pëlqim mundet të i bihet Aktvendimi për mënjanimin e objekteve në fjalë, pa kurrfarë kompensimi nga ky Organ e në shpenzime të vet investuesit.

Me rastin e festave kombëtare, tubimeve dhe për nevoja të tjera nga drejtoria e Urbanizmit - jeni të obliguar që objektet e cekura më lartë ti menjanoni për një kohë të caktuar.

Nëse ka ankesa nga ana e fqinjëve përshkak të zhurmës apo pengesave tjera të arsyeshme të banorëve për rreth, atëherë do të merren masa konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi

Investuesi është i obliguar që më së paku 30 ditë para skadimit të afatit të këtij Pëlqimi të parashtrioi kërkesë të re për zgjatjen e afatit për shfrytëzimin e hapsirës publike.

Për mos kryerje të punëve sipas këtij Pëlqimi , inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj.

Ky Pëlqim pushon të vlej nëse investuesi nuk i vendos këto brenda afatit të cituar në këtë Pëlqim.

A r s y e t i m

Duke e shqyrtuar kërkesën e investuesit **Ilir Mazreku**, nga Suhareka, Komuna Suharekë, ky Organ konstatoi se kërkesa është e arsyeshme dhe se të përmendurit mundet të i lejohet vendosja e objekteve të cituara më lartë si dhe shfrytëzimi i hapsirës publike - tokës shoqërore para lokalit të tij afarist, në një sipërfaqe prej **12.00 m²**, me afat të caktuar me këtë Pëlqim.

Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e rregullimit të tokës ndërtimore.


Kërkesës i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e Pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe shfrytëzim të hapsirës publike konform Rregullores mbi tarifatat dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. pika 8.8.5.- në vlerë prej **15.00 euro**.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtit .

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës :
Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë:
Visar Kuçi

